



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

<b>REFERENCË:</b>					
<b>Për/Za/To:</b>		Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal			
<b>Përmes/Preko/Through:</b>		Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL			
<b>CC:</b>					
<b>NGA/OD/FROM:</b>		Kujtim Aliu, Kryesues i komisionit Alban Mitati, Anëtar Erblin Hetemi, Anëtar			
<b>Tema/Subjekat/Subject:</b>					
<b>Nr. i zyrës:</b>	<b>13/15</b>	<b>Lokacioni:</b>		<b>Data:</b>	
<b>Br. kancelarije:</b>	<b>Kati</b>	<b>Kucni:</b>	<b>Ndërtesa e ish "Rilindjes",</b>	<b>Datum:</b>	<b>22.11.2023</b>
<b>Room No.:</b>	<b>13</b>	<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
<b>PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL</b>					<b>X</b>
<b>PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE</b>					<b>X</b>

I nderuar, Ministër z. Krasniqi

Bazuar në vendimin e U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së, Nr. 02-901, të datës, 22.11.2023, komisioni për hartimin e kriterëve për thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në komunat, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan, dhe Zubin Potok, në përbërje: Kujtim Aliu - Kryesues i komisionit, Alban Mitati - Anëtar, Erblin Hetemi - Anëtar, në takimin e caktuar me datë: 22.11.2023, kanë përcaktuar kriteret e nevojshme për përfituesit nga kjo thirrje publike.

Komisioni për thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan, dhe Zubin Potok, ka përcaktuar kriteret e përgjithshme, dhe dokumentacionin e nevojshëm i cili do të dorëzohet nga aplikuesit.

Bashkangjitur gjeni kriteret për thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan, dhe Zubin Potok.

Me respekt,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 22.11.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në mbështetje të kapitullit III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, shtojcën 1-(9) të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.17/174, i datës 22.11.2023, shpallë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR NDËRTIMIN E SHTËPIVE PËR PJESËTARET E KOMUNITETEVE JO SHUMICË NË KOMUNAT MITROVICË VERIORE, ZVEÇAN, LEPOSAVIQ, DHE ZUBIN POTOK PËR TË CILËT NDIHMA ËSHTË E NEVOJSHME**

Kjo thirrje publike nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka për qëllim që pjesëtareve të komuniteteve jo shumicë në komunat e lartcekura, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, të cilët nuk kanë kushte adekuate të banimit, me qëllim të ju krijohen kushte normale për jetesë.

Për financimin e kësaj thirrje janë të ndara 1,000,000.00 €.

**Kriteret për mbështetjen në ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për të cilët ndihma është e nevojshme, si në vijim:**

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të posedoj dokument identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Vërtetim të lëshuar nga komuna mbi vendbanimin, dhe dëshmi të posedimit të pronës për ndërtimin e shtëpisë në emër të aplikuesit ose familjarëve të tij (gjyshërit, prindërit, vëllezërve, motrave);
3. Të mos ketë përfituar ndihmë për ndërtim të shtëpisë nga ana e Institucioneve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare.

### **Dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet:**

1. Aplikacionin/Kërkesën (shkarko në web, <https://mapl.rks-gov.net/>) të plotësuar më të gjitha të dhënat dhe të nënshkruar nga ana e aplikuesit;
2. Deklaratën nën betim (shkarko në ueb, <https://mapl.rks-gov.net/>) që nuk ka përfituar më parë ndihmë;
3. Kopjen e Letërnjoftimit për aplikuesin;
4. Certifikatën e bashkësisë familjare;
5. Certifikatën e pronësisë ose dokument i noterizuar mbi disponueshmërinë e pronës, në emër të aplikuesit ose familjarëve si: gjyshërit, prindërit, vëllezërve, motrave.

### **Informata plotësuese**

*Prioritet në kushte të barabarta duhet të kenë kategoritë si në vijim:*

1. *Përfituesit potencialë ose familjar me nevoja të veçanta;*
2. *Përfituesit potencialë me familjar në gjendje të rëndë shëndetësore;*
3. *Përfituesit potencialë që nuk janë të punësuar dhe nuk janë përfitues të skemës sociale;*
4. *Prindërit vetë ushqyese;*
5. *Numri i anëtarëve të familjes.*

### **Periudha e aplikimit:**

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në web faqen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ( <https://mapl.rks-gov.net/> ). Të gjitha informatat e nevojshme dhe formularët për aplikim në këtë thirrje publike, mund t'i gjeni në web faqe të Ministrisë, <https://mapl.rks-gov.net/> si dhe në ndërtesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL, ndërtesa e Rilindjes).

**Thirrja do të jete e hapur nga data, 23.11.2023 deri me datë, 02.12.2023, e shtunë. Aplikimet pas këtij afati nuk pranohen.**

**Aplikuesit që aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin në kopje fizike në katin përdhes në Ndërtesën e Qeverisë (ish Rilindja) për çdo dite pune nga ora, 09:30 deri 12:00 dhe nga ora 13:00 deri 15:30.**

Aplikacionet duhet të dorëzohen në mënyrë fizike, të jenë të mbyllura në zarf, në të cilin shkruhet:

- *Emri dhe Mbiemri i Aplikuesit;*
- *Komuna e Aplikuesit;*
- *Data e aplikimit.*

Gjithashtu informacione dhe sqarime shtesë mund të merren direkt nga zyrat e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në email adresën: [alban.mitati@rks-gov.net](mailto:alban.mitati@rks-gov.net) ose në numrin e telefonit +38 200 64 116.